



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave*  
*Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance*

*Departamenti i Buxhetit Komunal/ Departamentat Opstinske Budzeta / Municipality Budget Department*

**RAPORT I VLERËSIMIT TË PËRSHTATËSHMËRISË SË SISTEMIT TË  
FINANCIMIT KOMUNAL PËR VITIN 2014**

Sekretaria e Komisionit të Granteve  
Ministria e Financave  
Mars, 2015

## **Përmbajtja**

1.	HYRJE .....	3
2.	VENDIMET E KOMISIONIT TË GRANTEVE 2014 .....	3
3.	REZULTATET E VLERËSIMIT 2014 .....	3
a.	Granti i Përgjithshëm: .....	3
b.	Granti Specifik i Arsimit .....	4
c.	Granti Specifik i Shëndetësisë .....	4
d.	Të Hyrat Vetanake Komunale .....	4
4.	REKOMANDIMET .....	5

## 1. HYRJE

Ky raport prezanton vlerësimin e Komisionit të Granteve (KG) mbi përshtatshmërinë e sistemit të financimit të nivelit komunal përgjatë vitit 2014. Raporti paraqet rezultatet e vlerësimit dhe sfidat kryesore të identifikuara nga KG, dhe më pastaj ofron rekomandime për përmirësime të mëtutjeshme në sistemin e tanishëm të financimit komunal.

Vlerësimi i KG bazohet në parimet e përcaktuara me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (LVL). Më saktësisht, përshtatshmëria e sistemit është vlerësuar duke matur zbatimin e kriterëve bazë të përcaktuara në LFPL për ndarjen e granteve ndërqeveritare dhe përfshirjen e vlerësimeve të të hyrave vetanake komunale në buxhetin e qeverisë së përgjithshme.

## 2. VENDIMET E KOMISIONIT TË GRANTEVE 2014

Për vitin 2014, Komisioni i Granteve ka aprovuar grantet qeveritare për financimin e komunave, si vijon:

- Granti i Përgjithshëm - në shumë prej Eur. 137.6 mil.
- Granti Specifik për Arsim - në shumë prej Eur. 142.6 mil.
- Granti Specifik për Shëndetësi - në shumë prej Eur. 39.4 mil.
- Financimi për Shëndetësi Sekondare – në shumë prej Eur 1.8 mil.
- Financimi për Shërbime Rezidenciale – në shumë prej Eur. 0.2 mil
- Përfshirjen e parashikimit të të hyrave vetanake komunale në buxhetin e Qeverisë së Përgjithshme në shumë prej Eur. 67.2 mil.

Përgjatë procesit buxhetor, Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa ka ndarë mjete shtesë prej Eur. 1.4 mil. për nivelin lokal, që rezulton me rritjen përkatëse në grantin e përgjithshëm, të aprovuar me Ligjin e Buxhetit për vitin 2014.

## 3. REZULTATET E VLERËSIMIT 2014

### a. Granti i Përgjithshëm:

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal përcakton parimet, kriteret dhe formulat bazë për ndarjen e grantit të përgjithshëm individualisht për komuna. Granti i përgjithshëm me sistem të mbyllur llogaritet me pjesëmarrje prej 10 për qind të të hyrave të projektuara të buxhetit të përgjithshëm, ndërsa që alokimi i mëhershëm për kokë banori është përmirësuar duke i shtuar disa parametra, që në radhë të parë reflekton diversitetin etnik dhe territorial të komunave.

*Komisioni i Granteve vlerëson se kriteret e aplikuar në formulën bazë për ndarjen e grantit të përgjithshëm individualisht sipas komunave për vitin 2014 dhe të aprovuar nga KG kanë qenë në përputhje me LFPL.*

### **b. Granti Specifik i Arsimit**

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal përcakton standardet dhe kriteret bazë mbi ndarjen e grantit specifik për arsimin parauniversitar të propozuar nga MASHT dhe në linjë me politikën sektoriale mundëson përcaktimin e ndikimit të qëndrueshëm buxhetor për financimin e standardeve minimale në sektorin e arsimit. Granti specifik i arsimit me sistem të hapur, ligjërisht bazohet në koston minimale të standardeve për ofrimin e shërbimeve efikase. Krahasuar me vitin paraprak, numri i nxënësve për vitin 2014 ka shënuar një rënie në total të komunave, sipas të dhënave nga MASHT dhe të aprovuar nga Komisioni i Granteve.

*Komisioni i Granteve vlerëson se përcaktimi i grantit specifik për arsim në vitin 2014 sipas komunave është bazuar në formulën e propozuar nga MASHT, dhe është në linjë me parimet e përcaktuara në LFPL. Megjithatë, KG vlerëson se përshtatshmëria e sistemit të financimit komunal të arsimit sfidohet nga kualiteti i statistikave të grumbulluara mbi të cilat aplikohen kriteret e LFPL.*

### **c. Granti Specifik i Shëndetësisë**

Deri para hyrjes në fuqi të LFPL, përcaktimi i grantit specifik shëndetësor ishte i bazuar në konceptin e metodës së thjeshtuar për kokë banori. Ndërsa, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji modeli me sistem të hapur që mbështet alokimin e grantit specifik shëndetësor parasheh parametra standard si mosha dhe struktura gjinore e popullsisë, numri mesatar i vizitave dhe shërbimeve shëndetësore të regjistruara dhe kostoja mesatare përkatëse për çdo komunë. Megjithatë, për shkak të mungesës së statistikave demografike dhe shëndetësore, përpjekjet e ndërlydhura të modelimit në praktikë duhej të jenë të kufizuara në zbatimin e alokimit të thjeshtë për kokë banori të shumës së përcaktuar në bazë të numrit të vlerësuar të vizitave dhe koston e llogaritur për vizitë të observuar në komuna.

*Komisioni i Granteve vlerëson se aplikimi dhe përcaktimi i parimeve të alokimit të grantit specifik shëndetësor të përcaktuara me LFPL është dëmtuar nga mungesa e raportimit të statistikave relevante demografike dhe të kujdesit shëndetësor. Përveç kësaj, janë shqetësuese përpjekjet e vazhdueshme të qeverisë qendrore për të vlerësuar koston mesatare të shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor, që çon në reduktimin e të drejtës për grantin shëndetësor për të gjitha komunat.*

### **d. Të Hyrat Vetanake Komunale**

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka rikonfirmuar dhe ka fuqizuar autoritetin komunal sa i përket përcaktimit, administrimit dhe mbledhjes së të hyrave vetanake komunale (THVK). Komunat kanë shfrytëzuar një shkallë të gjerë të THVK potenciale, ku mund të mbledhin taksat komunale, të vejnë tarifa dhe të vënë ngarkesa mbi një shkallë të gjerë të aktiviteteve dhe dokumenteve civile. Komunat gjithashtu zhvillojnë aktivitete komerciale veçmas për prona të patundshme që mund të gjenerojnë të ardhura vetanake potenciale.

*Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe analizat gjithëpërfshirëse të performancës së komunave, nga prizmi i kapaciteteve reale të inkasimit të të hyrave vetanake nga tatimi në pronë si e hyrë potenciale për komunat, Komisioni i Granteve konkludon se niveli i projeksioneve mbi inkasimin përkatës ka qenë i ulët, përkatësisht nën nivelin real të kapaciteteve të inkasimit.*

#### 4. REKOMANDIMET

Për të rritur përshtatshmërinë e ndarjes së *grantit specifik të arsimit* si element i financimit komunal, Komisioni i Granteve rekomandon si në vijim:

- Përmirësimin dhe zbatimin efikas të Sistemit të Menaxhimit të Informatave nga MASHT përmes Drejtorive Komunale të Arsimit për raportimin e statistikave bazë në Arsimin parauniversitar;
- MASHT-i në pajtim me mandatin e përcaktuar ligjor duhet të zhvilloj kapacitetet e nevojshme për shpërndarjen në kohë të standardeve arsimore, parametrave të formulës, si dhe të inputeve mbështetëse të parashikuara në LFPL;
- Saktësia, besueshmëria, transparenca, dhe disponueshmëria e statistikave të arsimit me kohë duhet të sigurohet nga MASHT për të gjitha Drejtoritë Komunale të Arsimit, duke përfshirë komunitetet e pakicave, për të cilat të dhënat statistikore nuk janë përditësuar për vitet e fundit shkollor 2009-2014;
- Projektimi dhe zbatimi i formulës së grantit specifik për arsim, duke përfshirë edhe implikimet e tija më afatgjatë për buxhetin komunal, nuk duhet të shikohet si një veprim i pavarur, por duhet të ndërmerret brenda kontekstit të politikave sektoriale të Qeverisë, rrjedhimisht të jetë e integruar plotësisht në KASH për arsim;

Për përmirësimin e mëtutjeshëm të financimit përmes *grantit specifik për shëndetësi*, Komisioni i Granteve rekomandon:

- MSH të inkorporoj standardet e përcaktuara për ofrimin e shërbimeve parësore shëndetësore në grantin specifik të shëndetësisë sipas LFPL dhe të integruara në KASH.
- MSH duhet të siguroj zbatimin efikas të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në shëndetësi primare dhe sekondare: kriteret për gjininë dhe moshën, duke përfshirë raportimin e statistikave bazë demografike dhe kriterëve tjera mbi regjistrimin e numrit të vizitave nëpër të gjitha komunat.

Komisioni i Granteve po ashtu rekomandon fuqizimin e kapaciteteve komunale për të ngritur performancën reale të inkasimit të të hyrave vetanake komunale, dhe në veçanti nga tatimi në pronë.